REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
DREJTORIA E ARSIMIT KULTURËS TURIZMIT RINISË DHE SPORTIT

Nr.3853Prot Krumë 27 . 10 .2025

NJOFTIM

Për regjistrimin e fëmijëve në çerdhen publike të Bashkisë Has për vitin 2026

Bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", Ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar" I ndryshuar , Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror", Ligjin nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"; ligj nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Bashkia Has njofton të gjithë prindërit dhe kujdestarët ligjorë se ka filluar procesi i regjistrimit të fëmijëve në çerdhen publike. Regjistrimet do të bëhen pranë Drejtorisë së Arsimit Kulturës Turizmit Rinisë dhe Sportit, Bashkisë Has.

Kriteret e pranimit:

• Fëmijët rezidentë në territorin e Bashkisë Has;
• Fëmijët e moshës 6 muaj deri në 3 vjeç,

Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim:

Prindi ose kujdestari ligjor duhet të paraqesë këto dokumente:
1. Kërkesë me shkrim për regjistrim (plotësohet në zyrë);
2. Certifikatë personale e fëmijës;
3. Certifikatë familjare;
4. Vërtetim banimi në Bashkinë Has;
5. Vërtetim mjekësor dhe kartelë vaksinimi nga qendra shëndetësore;
6.Kopje të kartës së identitetit të prindërve / kujdestarëve;
7.Vërtetim pune i prindërve (ose vërtetim nga Zyra e Punës / Ndihma Ekonomike, sipas rastit);
9. Dokumente shtesë për raste specifike (vendim kujdestarie, vërtetim për status social, etj.).

Mënyra e aplikimit:

Dokumentet dorëzohen dorazi në: Drejtorinë e Arsimit Kulturës Turizmit Ririsë dhe Sportit.
Orari i pritjes: nga ora 08:00 deri 16:00, çdo ditë pune.
• Çerdhja publike ofron ushqim, kujdes shëndetësor bazë dhe edukim të hershëm sipas standardeve të miratuara kombëtare.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

KRYETARI

Miftar DAUTI

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Bashkia Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al